

Adrian Brisku (ed.)

Njëqind vjet marrëdhënie shqiptaro-çeko (sllovake)

Simpati reciproke dhe kontakte në rritje

KAROLINUM

NJËQIND VJET MARRËDHËNIE SHQIPTARO-ÇEKO(SLLOVAKE)
SIMPATI RECIPROKE DHE KONTAKTE NË RRITJE

Adrian Brisku (ed.)

———

Recensentë:
doc. PhDr. Ladislav Hladki, CSc., Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të Republikës Çeke
Mgr. Tomash Hrobak, Ph.D., Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë i Universitetit të Karlit

Autorë:
Orkida Backus Borshi
Adrian Brisku
Robert Dobra
Maqej Krrzhepinski
Ilirian Kuka
Ana Lalaj
Jaroslav Ludva
Piro Milkani
Artan Puto
Prrzhemisl Vinsh

Botues: Universiteti i Karlit, Shtëpia Botuese Karolinum
Pragë 2022
© Universiteti i Karlit, 2022
Teksti © Adrian Brisku et al., 2022
Editor (redaktor shkencor) © Adrian Brisku, 2022
Përkujdesja grafike: Jan Sherih
Përgatitja teknike e vëllimit: Shtëpia Botuese Karolinum
Botimi i parë

"Ky libër u botua me mbështetje të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Karlit."

Libri është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës Kombëtare të Republikës Çeke.

ISBN 978-80-246-5251-1 (pdf)
ISBN 978-80-246-5249-8



Univerzita Karlova
Nakladatelství Karolinum

www.karolinum.cz
ebooks@karolinum.cz

Përmbajtja

Në vend të hyrjes: Më shumë se njëqind vjet marrëdhënie diplomatike shqiptaro-çeke (*Adrian Brisku*) 7

Pjesa e I-rë **Fillimet e njohjeve të njëri-tjetrit: midis Luftës së Parë e Luftës së Dytë Botërorë** 21

Kujtimet e ushtarëve çekë që shërbyen gjatë Luftës së Parë Botërore në Shqipëri (*Prrzhemisl Vinsh*) 23

Çekët në malet e Shqipërisë: etnografia e fiseve malore në malet e Shqipërisë së veriut në kohën e Luftës së Parë Botërore në veprën e Karel Sellnerit (*Robert Dobra*) 36

Periudha midis dy luftërave botërore, fillimi i marrëdhënieve diplomatike çekosllovako-shqiptare (*Maqej Krrzhepinski*) 51

Pjesa e II-të **Nga një forcim në ftohje të marrëdhënieve: nga paslufta deri në rënien e perdes së hekurt** 71

Pushtimi sovjetik i Çekosllovakisë në vitin 1968 dhe qendrimi i udhëheqjes komuniste shqiptare ndaj shtypjes së "Pranverës së Pragës": më afër Pekinit nëpërmjet Pragës (*Artan Puto*) 73

Disa veçori në marrëdhëniet ekonomike e tregtare midis Shqipërisë dhe Çekosllovakisë në komunizëm (*Ana Lalaj*) 95

Marrëdhëniet kulturore çekosllovake-shqiptare që nga viti 1945 (*Piro Milkani*) 113

Pjesa e III-të **Lidhje më të ngushta përmes arsimit, integrimit europian, investimeve dhe turizmit: dinamikat pas-socialiste** 123

Rilindja e albanologjisë në Universitetin e Karlit (*Orkida Backus Borshi*) 125
Marrëdhëniet e sotme Shqipëri-Çeki (*Ilirian Kuka*) 133
Turizmi si një instrument i fshehtë por efektiv i integrimit (*Jaroslav Ludva*) 139

Summary 143
Autorët 144

Në vend të hyrjes: Më shumë se njëqind vjet marrëdhënie diplomatike shqiptaro-çeke[1]

Adrian Brisku

Më 5 korrik 2022, Republika e Shqipërisë dhe Republika Çeke shënojnë 100-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis tyre. Ky njëqindvjetor shërben si shkak për të pyetur, hulumtuar e diskutuar: si kanë lindur, si janë zhvilluar, madje edhe për të dhënë përshtypje si po ecin marrëdhëniet midis këtyre dy shteteve të vegjël në lëmin e diplomacisë, por jo vetëm.

Me këtë rast u mbajt konferenca e parë akademike ndërkombëtare "Njëqind vjet marrëdhënie çeko(sllovake)-shqiptare," e organizuar më 26 nëntor 2020 nga Instituti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare[2] në bashkëpunim të ngushtë me Katedrën e Studimeve Sllavo-jugore e Ballkanike,[3] pjesë të Universitetit të Karlit në Pragë. Në këtë konferencë njëditore online – për shkak të pandemisë Covid-19 – morën pjesë historianë, hulumtues, ambasadorë e ish-ambasadorë çekë e shqiptarë. Ata trajtuan aspekte të ndryshme të këtyre marrëdhënieve fushën e politikës, diplomacisë, ekonomisë e tregtisë, kulturës si dhe kontaktet e marrëdhëniet e drejtpërdrejta midis shqiptarëve e çekëve, që kapërcejnë harkun kohor njëshekullor.

1 Ky tekst u shkrua në shqip.

2 Dua të falenderoj drejtorin e Institutit docentin Tomash Nigrin (Tomáš Nigrin) për mbështjen kolegjiale dhe financiare për konferencën dhe këtë vëllim, sidomos për përthkimin e kontributeve nga shqipja në çekisht; përkthime për të cilat dua të falenderoj mikun dhe kolegun tim Prrzhemisl Vinsh (Přemysl Vinš).

3 Po ashtu dua t'u shpreh falenderime kolegut dhe drejtorit të kësaj katedre, doktor Jaroslav Otçenashek (Jaroslav Otčenášek) për mbështje kolegjiale dhe finaciare për këtë vëllim për transkriptimin e disa ligjërimeve dhe për redaktimin gramatikor shqip të kontributeve të versionit shqip të këtij vëllimi dhe Mario Loçkës për transkriptimin, për përkthimin e redaktimin e disa prej tyre.

Ligjërimet në konferencë përbëjnë bazën e këtij vëllimi të titulluar: *Njëqind vjet marrëdhënie shqiptaro-çeko(sllovake). Simpatike reciproke e kontakte në rritje*.

Zanafilla e idesë për hulumtimin e marrëdhënieve historike midis të dy shteteve lindi në një bisedë në fillim të vitit 2019 me ambasadorin e Shqipërisë në Pragë, z. Ilirian Kuka në mjediset e ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Pragë.[4] Ambasadori Kuka më ftoi për të biseduar për mundësitë e shtimit e gjallërimit të aktiviteteve mes të dy vendeve në fushën e kulturës.

Në këtë kontekst, si historian i historisë moderne – pranë Institutit të Studimeve Ndërkombëtare në Universitetin e Karlit – ideja për hulumtuar marrëdhëniet historike çeko-shqiptare, mu duk me vend. (Për shumë vite jam marrë me studimin e historinë moderne shqiptare, gjeorgjiane, historinë e reformimit të perandorive osmane e ruse. Kohët e fundit kam filluar të hulumtoj historinë çeke të fundshekullit të 19-të dhe fillimshekullit të 20-të). Ndërkohë që njëqindvjetori i lidhjeve diplomatike po afrohej, as historiografia shqiptare as ajo çeke nuk e kishin trajtuar këtë temë në mënyrë sistematike, mbështetur në burime arkivore.

Vlen të përmendet një korrespondencë e vitit 1955, mes Akademisë së Shkencave Çekosllovake dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme Çekosllovake, që gjeta në arkivat e Ministrisë se Punëve të Jashtme të Republikës Çeke. Akademia kërkonte të pyetej ambasada shqiptare në Pragë, nëse mund të sillnin një historian shqiptar për konferencën që do të organizohej me rastin e 10 vjetorit të çlirimit të Republikës Çekosllovake me temat: "Revolucioni Kombëtar e Demokratik" dhe "Historia e Demokracive Popullore." Konferenca do të organizohej më 28–30 prill 1955. Në përgjigje shprehej keqardhja e Ministrisë për faktin se nuk kishte historianë nga Shqipëria, si dhe studentë shqiptarë që studionin në universitetet çekosllovake, që mund të kumtonin mbi këto tema. Studentët shqiptarë në këto universitete studionin degë të shkencave natyrore, inxhinieri, mjekësi, artet e bukura, por asnjë nuk studionte për histori.[5]

Tani, në periudhën post-socialiste, këto mangësi kapacitetesh nuk ekzistojnë. Në fakt ka një interes të dukshëm të historianëve e hulumtuesve

4 Presidenti i Republikës Çeke, z. Milosh Zeman (Miloš Zeman) akreditoi z. Kuka ambasador të Republikës së Shqipërisë në Pragë në dhjetor të 2018.

5 Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Çeke (AMZV), seksion-territoret në përgjithësi, 1945–1959, F. 1, D. 5, Përgjigja Ambasadës shqiptare në Pragë me 27 prill 1955, notës se e Ministrisë së punëve të jashtme çekosllovake më 17 mars 1955.

të rinj nga të dy vendet për tema, ngjarje, ide apo fenomene historike, kulturore e politike, reciprokisht, shqiptare e çeko(sllovake).

Fakti që deri tani nuk ka ndonjë trajtim të plotë e gjithanshëm, mund të kuptohet dhe në kontekstin se historianët shqiptarë dhe çekë janë angazhuar me ngjarje, aspekte dhe personalite të historisë moderne të shteteve përkatës, marrëdhëniet me vende fqinjë apo me shtete më të fuqishme. Në lëmin e historisë ndërkombëtare temat që trajtohen më shumë janë çështje si: luftrat, paqja, diplomacia, përplasjet apo shkëmbimet ideologjike apo civilizuese, marrëdhëniet ekonomiko-tregtare, ku Shqipëria e Çekia nuk duken të lidhura drejtpërdrejt.

Historiografitë shqiptare e çeke që nga krijimi i shteteve të tyre, përkatësisht më 28 nëntor 1912 dhe 28 tetor 1918 i përshkruajnë Shqipërinë e Çekinë – (si shtete fqinjë dhe jo me peshën e vende të më mëdha në Evropë) – si aktorë aktivë në rajonet përkatëse, Europës Juglindore dhe Europës Qendrore e Lindore.

Për ilustrim, që historiografitë përkatëse janë marrë me studimet e marrëdhënieve me vendet fqinjë vlen të përmenden një sërë punimesh historiografike dhe politiko-shkencore çeke për marrëdhëniet: çeko-gjermane,[6] çeko-austriake,[7] çeko-sllovake,[8] çeko-ruse,[9] çeko-britanike,[10] çeko-amerikane,[11] çeko-polake,[12] çeko-jugosllave,[13] e të tjera. Në historiografinë shqiptare gjënden punime të shumta mbi marrëdhëniet:

---

6 Për shembull shihni: Radomír Luža, *The Transfer of Sudeten Germans: a Study of Czech-German Relations, 1933–1962* (London: Routledge, 1964); Zdeněk Beneš dhe Václav Kural, redaktorë, *Facing History: The Evolution of Czech-German Relations in the Czech Provinces, 1848–1948* (Prague: Gallery, 2002); Břetislav Dančák dhe Vít Hloušek, *Towards Partnership: The Third Decade of Czech-German Relations* (Brno: Masaryk University, 2016).

7 Ota Konrád, *Nevyvážené vztahy: Čekoslovensko a Rakousko, 1918–1933* (Praha: Masarykův ústav a Archiv AV ČR, 2012).

8 Michal Marcháček, "Gustáv Husák: a Political Biography with a Special Emphasis on Czech-Slovak Relations in the 20th Century" (PhD diss., Charles University, 2017); Barbora Šedivá, "Forming of Identity through History Lessons: The Description of Czecho-Slovak Relations since the Middle Ages to Present in the Textbooks of the 20th Century," (BA Thesis, Charles University, 2014).

9 Jan Němeček dhe Emil Voráček, redaktorë, *Czech-Russian Relations in the 19th and 20th Centuries* (Prague: Historical Institute, 2011); Emil Voráček e kol., *In the Interest of a Great Power: Czechoslovakia and the Soviet Union 1918–1948* (Prague: Historical Institute, 2019).

10 Vít Smetana, *In the Shadow of Munich: British Policy towards Czechoslovakia, 1938–1942* (Prague: Karolinum Press, 2018).

11 Ivan Dubovický, *Czechs in America and Czech-American Relations in the Course of Five Centuries* (Prague: Epocha, 2018).

12 Tomáš Zahradníček, *Polish Lessons from the Prague Spring: three Essays on the History of the Political Thought, 1968–1981* (Prague, 2012).

13 Pavel Hradečný, *Politické vztahy Československa a Jugoslávie v letech 1925–1928 v zahraničním i vnitřním kontextu* (Praha: Academia, 1988); Jan Pelikán, *Yugoslavia and the Prague Spring* (Prague: Faculty of Arts, Charles University, 2008); Milan Sovilj, *Czechoslovak-Yugoslav Relations*

shqiptaro-italiane,[14] shqiptaro-greke,[15] shqiptaro-angleze,[16] shqiptaro--amerikane,[17] shqiptaro-jugosllave/serbe,[18] shqiptaro-malazeze,[19] e të tjera.

Nga ana tjetër, në lëmin e historisë krahasuese, mund të përmend punimin tim të titulluar, "Të qënurit komb i vogël në Boheminë habsburge, Shqipërinë osmane dhe Gjeorgjinë cariste nga fundshekulli 19-të – fillimshekulli i 20-të," pjesë e vëllimit, "Politika e të qënurit vend e komb i vogël në Europë: madhësia, identiteti dhe marrëdhëniet ndërkombëtare që nga vitet 1800."[20]

Në këtë vëllim për herë të parë krahasohen ide të artikuluara në të dy kombet në dekadat e fundit të parandorive përkatëse austro-hungareze e osmane nga figura intelektuale e politike për kombet e tyre si: presidenti çekosllovak Tomash G. Masarik (Tomáš G. Masaryk, 1850–1937); kryeministri i parë çekosllovak Karel Kramarrzh (Karel Kramář, 1860–1937) dhe atyre shqiptarë, themeluesi i shtetit shqiptar Ismail Qemali, intelektuali Sami Frashëri.[21]

Pra, nuk mund të flitet për ndonjë punim të mirëfilltë shumëplanësh mbi marrëdhëniet historike mes dy vendeve. Gjithsesi vlen të përmenden se ekzistojnë disa kontribute në të dy vendet. Këtu mund te përmendet artikulli im rreth mendimeve politiko-ekonomike të Masarikut e Kramarzhit gjatë dekadave të fundit të perandorisë austro-hungareze dhe formimit të shtetit çekosllovak me titull: "Nga rinegocimi me perandorinë në krijimin e shtet-kombit: rasti i Bohemisë/Çekosllovakisë në mendimin

in 1939–1941: from the Dissolution of the Czechoslovak Republic to the Occupation of the Kingdom of Yugoslavia (Prague: Faculty of Arts, Charles University, 2016).

14 Arben Cici, *Marrëdhëniet shqiptaro-italiane në vitet 1920–1934* (Tiranë: Afërdita, 2002); Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian (1939–1943)* (Tiranë, 2005).

15 Milto Spiromilo, *Greqia dhe Shqipëria* (Kajro, 1942); Ledia Dushku, "Përpjekjet e politikës greke për aneksimin e Shqipërisë së jugut: nga diplomacia në veprime të armatosura (shtator 1913-shkurt 1914)," *Studime Historike* 1–2 (2010); Romeo Gurakuqi, *Principata e Shqipërisë dhe Mbretëria e Greqisë 1913–1914* (Tiranë: UET Press, 2011).

16 Pranvera Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze 1919–1927* (Tiranë: Nerada, 2005).

17 Constantine Demo, *The Albanians in America* (Boston, 1960); Iljaz Gogaj, *Shkollat amerikane në Shqipëri* (Tiranë: Drita, 1995).

18 Thoma Murzaku, *Politika e Serbisë kundrejt Shqipërisë gjatë Luftëes Ballkanike 1912–1913* (Tiranë, 1987); Xheladin Shala, *Marrëdhëniet shqiptaro-serbe 1912–1918* (Prishtinë, 1990); Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918–1927* (Tiranë, 1992); Emine Arife Bakalli, *Marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave 1929–1939* (Prishtinë, 1995).

19 Isa Bicaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-malezeze (1881–1914)* (Prishtinë, 2003).

20 Adrian Brisku, "Dealing with Smallness in Habsburg Bohemia, Ottoman Albania and Tsarist Georgia in the late Nineteenth and early Twentieth Century," në *Politics of Smallness in Modern Europe: Size, Identity and International Relations since 1800*, redaktor, Samuël Kruizinga (London: Bloomsbury, 2022), 57–87.

21 Po aty.

politiko-ekonomik të Tomash G. Masarikut e Karel Kramarzhit, 1890-1920-të" (2017).[22] Mund të përmendet artikulli i historianes Ana Lalaj të titulluar: "1968: Pranvera a Pragës dhe 'Kështjella' Shqiptare," botuar në vëllim *Europa Lindore në 1968*, (2018) ku historiania trajton marrëdhëniet në fusha të ndryshme mes dy vendeve, fund vitet 1940 – fund vitet 1950-të.[23]

Kontributet e historianëve çekë mbi historinë e Shqipërisë vijnë veçanërisht nga historiani Pavel Hradeçni (Pavel Hradečný – i diplomuar në 1960 për Albanologji në Universitetin e Tiranës,)[24] me librin e titulluar *Historia e Shqipërisë*, botuar në 2008, dy vjet pas vdekjes.[25] Ky libër cilësohet si "sinteza e parë çeke mbi historinë e këtij vendi [Shqipërisë] gjeografikisht jo shumë i largët, por për lexuesin e zakonshëm çek, gjithsesi ekzotik."[26] Në 1977, Hradeçni botoi librin *Republika Populore Socialiste e Shqipërisë*.[27]

I vetmi tekst që diskuton drejtpërdrejt marrëdhëniet midis të dy vendeve është përmbledhja me titull "Marrëdhëniet çeko-shqiptare," e autorëve Hradeçni, Kamil Pikal dhe Ladislav Hladki (Ladislav Hladký) botuar në librin e Hladkit të titulluar *Marrëdhëniet e çekëve me kombet dhe vendet e Europës Juglindore*, botim i Institutit të Historisë së Akademisë së Republikës Çeke në 2010.[28]

Vlen to përmendet dhe teza e diplomës të studiuesit Maqej Krrzhepinskit (Matěj Křepinský), "Koha e qeverisjes së Ahmet Zogut nga pikëpamja e diplomacisë çekosllovake" e mbrojtur në Universtetin e Karlit më 2017,[29] një pjesë e së cilës vjen si kontribut në këtë vëllim me titullin, "Periudha e midis dy luftrave botërore si fillim i marrëdhënieve diplomatike çekosllovako-shqiptare."

---

22 Adrian Brisku, "Renegotiating the Empire, Forging the Nation (State): The Case of Bohemia/Czechoslovakia through the Political-Economic Thought of Thomas G. Masaryk and Karel Kramář," *Nationalities Papers* 45, no. 4 (2017), 632–650.

23 Ana Lalaj, "1968: The Prague Spring and the 'Albanian Castle,'" në *Eastern Europe in 1968*, redaktorë, Kevin McDermott dhe Matthew Stibbe (London: Palgrave Macmillan, 2018), 235–55.

24 Tomáš Chrobák, "Recenze: Dějiny Albánie," *Akademický Bulletin*, aksesuar më 11 maj 2021. http://abicko.avcr.cz/2008/6/15/dejiny-albanie.html.

25 Pavel Hradečný dhe Ladislav Hladký, *Dějiny Albánie* (Praha: Nakladatelství Lidové Noviny, 2008).

26 Chrobák, "Recenze."

27 Pavel Hradečný, *Albánská socialistka lidová republika* (Praha, 1977).

28 Ladislav Hladký, redaktor, *Vztahy Čechů s národy a zeměmi jihovýchodní Evropy* (Praha: Historický Ústav, 2010).

29 Matěj Křepinský, "Období vlády Ahmeta Zoga pohledem československé diplomacie," (BA Thesis, Charles University, 2017).

Në përmbledhjen e Hradeçnit, Hladkit e Pikalit, sipas një parimi kronologjik, paraqiten konturet kryesore të këtyre marrëdhënieve, të cilat në një farë mase replikohen edhe në këtë vëllim.[30] Nëse përmbledhja e tyre (mbështetur më shumë në literaturë ekzistuese sesa burime arkivore) përbëhet nga pesë periudha, duke filluar nga shekulli i 14-të deri në atë të 21-të, ky vëllim ka tre periudha që përfshihen në harkun kohor fillimshekulli 20 – fillimshekullin 21.

Ky periodizim ndryshe bëhet për faktin se kemi të bëjmë me kontakte e marrëdhënie të drejtpërdrejta midis shqiptarëve e çeko(sllovakëve). Këto kontakte e marrëdhënie të drejtpërdrejta politiko-diplomatike, ekonomiko-tregtare kulturore dhe njerzore shtjellohet në këtë ketë vëllim nga perspektiva entografike, letrare, e historike – këto të fundit si rrallë më parë, mbështeten në burime arkivore në të dy vendet (Arkivat e Ministrisë së Punëve të Jashtme çeke në Pragë, Memorialit të Letërsisë Kombëtare në Litomjerrzhice, në Arkivat Qëndrore të Shtetit në Tiranë, si dhe në Arkivat e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë në Tiranë) – si dhe nga prezantime përshkruese e reflektuese të ambasadorëve e ish-ambasadorëve shqiptarë e çekë.

Pjesa e parë e këtij botimi titullohet: "Fillimet e njohjeve të njëri-tjetrit, midis Luftës së Parë e Luftës së Dytë Botërorë" trajton pikërisht këtë periudhë. Këtu vërehen jo vetëm kontakte të drejtpërdrejta midis çekëve e shqiptarëve, por dhe marrëdhëniet diplomatike e tregtare midis të dy shteteve të rinj. Për krahasim, dy periudhat e para në botimin e Hradeçnit, Hladkit e Pikalit nuk flasin për kontakte apo marrëdhënie të drejtpërdrejta, përveç disa rasteve të fundshekullit të 19-të. Për ilustrim, periudha e tyre e parë, të cilën e quajnë "Faza më e hershme të kontakteve çeko-shqiptare," përkon me vitet 50–60 të shekullit të 14-të deri në fillim të shekullit të 19-të. Në të trajtohet jehona në hapësirën boheme/çeke e luftrave të heroit kombëtar të Shqipërisë, Gjergj Kastriot-Skënderbeut (1405–1468) kundër ushtrisë osmane. Kjo jehonë vazhdoi te lexuesit çekë në shekujt 15–16-të e më tutje. Ata theksojnë se deri në shekullin e 19-të, çdo lajm për shqiptarët në hapësirat çeke ishte indirekt. Çekët kishin filluar "t'i identifikonin shqiptarët me

30 Për redaktimim letrar të vëllimit dua të falenderoj edhe zotin Lulzim Çota një nga diplomatët që ka shërbyer në Ambasadën e Shqipërisë në Pragë në postin e zëvendës-shefit të Misionit në vitet 2014–2018. Interesant është fakti se në fillimet e karrierës së tij të mëparshme si gazetar në Shqipëri, në artikullin e tij të parë të botuar në shtypin e kohës më 21 gusht 1979, z. Çota ka dënuar pushtimin e Çekosllovakisë nga trupat ruse dhe të disa vendeve të Traktatit të Varshavës.

turqit muslimanë, kësisoj nuk kishin opinion të favorshëm ndaj tyre [shqiptarëve]."[31]

Periudha e dytë, të cilën autorët e quajnë "Marrëdhëniet çeko-shqiptare në shek. 19- fillim shek. 20," cilësohet "disa kontakte të para," por jo marrëdhënie. Kjo lidhet me rritjen e interesit të intelektualëve çekë, të ndikuar nga rryma romantike të kohës, për vende të largëta e ekzotike. Në gjysmën e dytë të shek. 19 ky interes përqëndrohet në historinë, gjuhën dhe kulturën shqiptare.

Si shembuj të tillë mund të përmendim: Pavel Josef Shafarrzhik (Pavel Josef Šafařík, 1795–1861), i cili u mor me studime gjuhësore e historike shqiptare. Filologu Jan Urban Jarnik (Jan Urban Jarník, 1848–1923), i cili botoi disa libra për gjuhën shqipe në fillim të viteve 1880, mund të jetë një nga të parët që vendosi e mbajti kontakte me figura të kulturës shqiptare, si folkloristi Thimi Mitka (1820–1900). Nga fundi i shek. 19 publicistë e gazetarë çekë udhëtuan në tokat shqiptare, si për shembull, Josef Jakob Touzhimski (Josef Jakob Toužimský, 1848–1903) apo të tjerë në prag të Luftës së Parë Botërore. Këta publicistë krijuan përfytyrime negative dhe pozitive mbi shqiptarët.[32] Ndërkaq shqiptarët, nuk kanë ndonjë përfytyrim as negativ as pozitiv për çekët në këtë kohë.

Periudha e tretë titullohet "Marrëdhëniet çekosllovako-shqiptare gjatë periudhës së dy luftrave."

Për autorët e mësipërm, mbarimi i Luftës së Parë Botërore shënon kohën kur "marrëdhëniet çeko-shqiptare ndryshojnë radikalisht."[33] Në këtë periudhë kemi të bëjmë jo vetëm me kontakte të drejtëpërdrejta e të shumta, por dhe marrëdhënie diplomatike, tregtare e shoqërore midis shqiptarëve e çekosllovakëve. Ndër të tjera autorët përmendin shkurtimisht krijimin në Pragë në vitin 1922 të "Shoqatës çekosllovako-shqiptare." Në vitin 1938 kjo shoqatë botoi librin me titull: "Shqipëria: reflektime mbi pozicionin e Shqipërisë në botë, historinë dhe vendin e saj, politikën shqiptare, ekonominë kombëtare dhe kulturën shqiptare."

Autorë e librit ishin shkrimtarë, gazetarë, gjeografë e ekonomistë çekosllovakë, të cilët ishin ushtarë në zonën e pushtuar nga Austro-Hungaria të shtetit të sapoformuar shqiptar. Këtu përmendet dhe figura

31 Pavel Hradečný, Ladislav Hladký dhe Kamil Pikal, "Česko-albanské vztahy," në *Vztahy Čechů s národy a zeměmi jihovýchodní Evropy*, redaktor, Ladislav Hladký (Praha: Historický Ústav, 2010), 253–262; 254.

32 Po aty, 255.

33 Po aty, 256.

e përfaqësuesit të parë diplomatik çekosllovak, Josef M. Kradlec (1889–1952), si "promotor i madh i marrëdhënieve çeko-shqiptare."[34]

Ky vëllim, ndërkaq, përbëhet nga gjashtë studime të mirëfillta analitiko-historike dhe tre kontribute të karakterit ligjërim/rrëfim. Në pjesën e pare përfshihen tre kontribute. Dy të parat trajtojnë kontaket e drejtërdrejta të ushtarëve çekë me shqiptarët në Shqipëri gjatë Luftës së Parë Botërore dhe përshtypjet. Disa prej ish-ushtarëve u bënë anëtarë të Shoqatës Çekosllovake-Shqiptare. Kontributi i tretë shtjellon në imtësi vendosjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve diplomatike midis të dy shteteve.

Kontributi i parë i titulluar "Kujtimet e ushtarëve çekë që shërbyen në Shqipëri gjatë Luftës së Parë Botërore," vjen nga albanologu Prrzhemisl Vinsh. Ai shtjellon këtë histori pak të njohur midis çekëve e shqiptarëve, kur pjesëtarët e të dyja kombeve ranë në kontakt për herë të parë për një kohë relativisht të gjatë e në mënyrë intensive. Vinsh paraqet dhe analizon disa vepra letrare (poezi dhe kujtime) të këtyre ushtarëve si: poezitë e poetit Stanislav Kostka Neumann (1875–1947); kujtimet e ushtarit Jaroslav Krrzhenek (Jaroslav Křenek, 1890–1964). Vinsh argumenton se përshtypjet e tyre ndikuan shumë në krijimin e një imazhi më kompleks ndaj shqiptarëve në Çekosllovaki, imazh që binte ndesh me imazhin e krijuar nga shtypi çek i paraluftës.

Po me këtë aspekt merret edhe kontributi i albanologut çek Robert Dobra i titulluar: "Çekët në malet e Shqipërisë, etnografia e fiseve në malet e Shqipërisë së veriut në kohën e Luftës së Parë Botërore në veprën e Karel Sellnerit." Mbështetur në vepra letrare dhe burime arkivore Dobra përqendrohet vetëm në figurën e shkrimtarit, arkeologut dhe etnografit amator, Karel Sellner (1873–1955), i cili shërbeu si ushtar në veri të Shqipërisë. Në këtë analizë theksohet se veprat e Sellnerit janë të karakterit etnografik – përmbledhje rreth traditave e identiteteve të popullsisë së zonës dhe rreth kanunit (të Lekë Dukagjinit).

Dobra argumeton se Sellneri, në mënyrë të pavetëdijshme, romantizoi shqiptarët e veriut të Shqipërisë. Rrëfimet e Sellnerit flasin për kontakte jo-armiqësore midis ushtarëve çekë (zyrtarisht ishin pushtues e shqiptarët edhe mund t'i luftonin) dhe banorëve shqiptarë. Me portretin etnografik të shqiptarëve, të illustruar dhe me materiale vizuale, Sellneri krijoi një imazh ndryshe për shqiptarët në Çekosllovaki. Në veprën e Sellnerit, Dobra sheh lidhje që mund të krijohen midis Albanologjisë, etnografisë dhe historiografisë çeke të kësaj periudhe.

34 Po aty, 257.

Kontributi i tretë i titulluar, "Periudha midis dy luftërave botërore si fillim i marrëdhënieve diplomatike çekosllovake-shqiptare," vjen nga albanologu Maqej Krrzhepinski. Bazuar në burime të shumta arkivore, Krrzhepinski argumenton se me njohjen reciproke diplomatike më 1922, të dy shtetet i vlerësuan marrëdhëniet e tyre si miqësore. Ai gjithashtu thekson se këto marrëdhënie u forcuan në fushën tregtare e ekonomike për shkak të interesave reciproke të forta të të dyja shteteve. Produktet dhe mallrat çekosllovake fituan reputacion të mirë në tregun shqiptar dhe për këtë mes dy vendeve u nënshkruan marrëveshje tregtare në vitet 1926 e 1934. Autori konstaton se marrëdhëniet politike ishin të dobëta.

Kjo e fundit, sipas Krrzhepinskit, ka të bëjë me faktin se Çekosllovakia nuk kishte ndonjë objektiv politik të drejtpërdrejt në Tiranë. Diplomatët çekosllovakë në Tiranë ishin të interesuar dhe mbështetnin ndikimin jugoslav, (Çekosllovakia dhe Jugosllavia ishin anëtare të Antantës së vogël) përballë influencës dhe presionit fashist italian mbi shoqërinë dhe shtetin shqiptar.

Pjesa a dytë e vëllimit titullohet: "Nga një forcim në ftohje të marrëdhënieve, nga paslufta deri në rënien e perdes së hekurt," përfshin periudhën 1945–1990. Ky periodizim përkon pak a shumë me periodizimin në librin e autorëve Hradeçnit, Hladki dhe Pikali, "Marrëdhëniet çekosllovako-shqiptare në vitet 1945–1989." Në të theksohet se krijimi i regjimit komunist në fund të Luftës së Dytë Botërore "i dha një hov të ri kontakteve zyrtare çekosllovako-shqiptare, të ndërprera gjatë viteve 1939–1945."[35] Në këtë periudhë Hradeçni, Hladki e Pikali trajtojnë pikat kryesore të këtyre marrëdhënieve. Autorët theksojnë se kontaket e para diplomatike u bënë në vitin 1947 në Tiranë nga ambasadori çekosllovak në Beograd. Marrëdhëniet në nivel ambasade u vendosën pasi Çekosllovakia u bë pjesë e bllokut sovjetik në 1948. Me krijimin e Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke (KNER) në 1949 dhe Traktatit të Varshavës në 1955 "krijohen marrëdhënie me zhvillim të shpejtë dypalësh… ku Shqipëria, gjatë viteve '50 të shek. 20, mori nga Çekosllovakia ndihmë gjithëpërfshirëse politike, ekonomiko-teknike, shëndetësore, kulturore e arsimore."[36] Po ashtu, pasi Shqipëria u prish me Bashkimin Sovjetik në 1961, këto marrëdhënie të shumanëshme u "zvogëluan në mënyrë drastike" në tre dekadat e mëtejshme.[37]

35 Po aty.
36 Po aty.
37 Po aty, 259.